



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.11, datë 17. 07. 2009

**PËR**

**“NIVELET E MASËS DITORE TË PËRFITIMIT ME TRAJTIM  
USHQIMOR QË FINANCON BASHKIA E TIRANËS PËR  
SPORTISTË TË KATEGORISË SË PARË, TË KLUBIT SPORTIV  
“TIRANA” DHE KLUBIT TË FUTBOLLIT “TIRANA”**

Në mbështetje të ligjit nr 8652, datë 31.07.200 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 26, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 9376, datë 21.04.2005, për” Sportin”; kreut të II-të të VKM-së nr.1720, datë 29.10.2008 për “Kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sportistëve, që i arrijnë këto nivele, si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive”; VKB-së nr. 1, datë 03.02.2009, për “Miratimin në parim të programit buxhetor afatmesëm për vitet 2009-2011 dhe miratimin e detajimit të buxhetit të Bashkisë së Tiranës, për vitin 2009”; pikës 7 të VKB-së nr.7, datë 30.03.2009 për “Riorganizimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të disa ndërrmarjeve në varësi të Bashkisë së Tiranës, përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sportistëve të nivelit të lartë si dhe mbi përdorimin e fondit rezervë” pas shqyrtimit të relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Kujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë nivelet e masës ditore të përfitimit me trajtim ushqimor për sportistin e kategorisë së parë për Klubin Sportiv “Tirana” që financon Bashkia e Tiranës si më poshtë:
  - sportistë bazë ( sportistë që marrin pjesë në veprimtaritë kombëtare të kategorisë së parë dhe superiore) - **1000 lekë/ ditë/ 25ditë/ muaj.**
2. Të miratojë nivelet e masës ditore të përfitimit me trajtim ushqimor për sportistin e kategorisë së parë për Klubin e Futbollit “Tirana” që financon Bashkia e Tiranës do të jetë:

- sportistë bazë ( sportistë që marrin pjesë në veprimtaritë kombëtare të kategorisë së parë dhe superiore) - **1000 lekë/ ditë/ 25ditë/ muaj.**
3. Të miratojë masën ditore të përfitimit me trajtim ushqimor që do të financojë Bashkia e Tiranës sipas kategorizimit të përcaktuar në Kreun e II-të, pika 4 të VKM-së 1720, datë 29.10.2008 si më poshtë :
- sportistë të perspektivës ( sportistë të cilët përfaqësojnë vendin tonë me ekipet përfaqësuese të moshave respektive) - **1000 – 1300 lekë/ ditë/ 25ditë/ muaj.**
  - sportistë të nivelit ndërkombëtar (sportistë të cilat arrijnë rezultate dhe rekorde të larta në sportet individuale në aktivitetet europiane dhe botërore, si dhe ata sportistë që përfaqësojnë vendin tonë me ekipet tona përfaqësuese në aktivitetet ndërkombëtare. **1300 – 1500 lekë/ ditë/ 25ditë/ muaj.**
4. Vlerësimi i cilësisë së sportistit të sporteve sipas kategorizimit të mësipërm, të bëhet me miratimin e këshillave të trajnerëve të të dy klubeve, si dhe të federatave përkatëse.
5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondi i buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2009.
6. Ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social, për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

**K R Y E T A R**